

VENDIM
Nr.353, datë 12.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË “GJUHËSI”,
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR
XHUVANI”, ELBASAN, DHE PËR KUOTËN E PRANIMIT E TARIFËN E
SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në fakultetin e shkencave humane, të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programit të studimeve të ciklit të dytë, në “Gjuhësi”.

Në përfundim të këtij programi studimesh, lëshohet “Diplomë e Nivelit të Dytë, DND, në gjuhësi”.

2.Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

3.Programi i studimeve të ciklit të dytë, realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.

4.Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2010-2011, është 20.

a)Në kuotën e mësipërme të këtij programi studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

5.Universiteti “Aleksandër Xhuvani” duhet të përcaktojë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe t’i bëjë publike paraprakisht.

6.Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7.Tarifa e shkollimit, për këtë program studimi të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010-2011, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8.Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i universitetit “A.Xhuvani” të Elbasanit, pa efekte buxhetore shtesë.

9.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti i Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha